

VENDIM
Nr.23, datë 12.12.2007

PËR MIRATIMIN E UDHËZIMIT
PËR DISA KATEGORI TË NDIHMAVE HORIZONTALE

Në mbështetje të nenit 17, shkronja “e” të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, Komisioni i Ndihmës Shtetërore,

VENDOSI:

1. Miratimin e udhëzimit “Për disa kategori të ndihmave horizontale”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Genc Ruli

UDHËZIM
PËR DISA KATEGORI TË NDIHMAVE HORIZONTALE

1. VLERËSIM I PËRGJITHSHËM

1.1 Hyrje

Ndihma shtetërore shihet si një nga mekanizmat e ndërhyrjes së shtetit për të rregulluar dështimet e tregut. Megjithatë, shteti në të gjitha rastet e ndërhyrjes së tij, duhet të ketë si parim kryesor funksionimin normal të një ekonomie tregu, duke ruajtur një balancë me politikat e tjera për zhvillimin ekonomik e shoqëror të rajoneve të veçanta e të vendit në tërësi.

Kur ndihma shtetërore jepet për të nxitur realizimin e objektivave të tillë të përgjithshëm, si punësimi, kërkimi dhe zhvillimi, mbrojtja e mjedisit ose ruajtja e qëndrueshmërisë rajonale, ajo mund të pranohet, vetëm nëse investimi i ndërmarrë jep efekte pozitive për shoqërinë, efekte të cilat nuk do të mund të realizoheshin nga burimet financiare të vetë ndërmarrjeve. Me anë të një politike të drejtë ndihme, mund të rregullohet dhe përmirësohet situata në një sektor të caktuar apo të nxiten ndërmarrjet për realizimin e investimeve, që ndikojnë në plotësimin e standardeve apo ofrimin e shërbimeve publike. Megjithatë, forma të tjera të ndihmës që ndikojnë ndjeshëm në konkurrencën në treg dhe që nuk shoqërohen me përfitime të tjera, konsiderohen të paligjshme dhe, si të tilla dënohen. Kjo përligj kërkesën për një monitorim të fortë të ndihmës shtetërore, nëpërmjet përcaktimit të kriterëve që duhet të ndiqen për vlerësimin apo kontrollin e masës së ndërhyrjes së shtetit në veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve.

Duke filluar nga data 1 janar 2006, në Republikën e Shqipërisë është në fuqi ligji nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore” dhe tri rregulloret në zbatim të tij “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, “Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale”, si dhe “Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës për shpëtimin dhe ristrukturimin e ndërmarrjeve në vështirësi”.

Neni 17, shkronja “e” dhe neni 18, shkronja “f” i ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, ngarkon Drejtorinë e Ndihmës Shtetërore dhe Komisionin e Ndihmës Shtetërore, respektivisht për hartimin dhe nxjerrjen e udhëzimeve në zbatim të këtij ligji.

Qëllimi i këtij udhëzimi është lehtësimi i punës së dhënësve të ndihmës shtetërore, në nivel qendror dhe vendor, nëpërmjet trajtimit më gjerësisht të koncepteve, kriterëve dhe procedurave që zbatohen për disa kategori ndihmesh horizontale, të përcaktuara në nenet 8, 9, 10, 11 dhe 12 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”.

Udhëzimi synon, në radhë të parë, të japë disa kriterë të përgjithshme që përdoren në analizën dhe vlerësimin e skemave të ndihmës dhe të ndihmave individuale, për të parë shkallën e tyre të përputhshmërisë me legjislacionin në fuqi të ndihmës shtetërore. Po këto kriterë duhet të përdoren edhe nga dhënësit e ndihmës, gjatë procesit të përgatitjes së akteve të ndryshme normative që lidhen me planet për dhënien e ndihmës shtetërore.

Me qëllim që të sigurohet kuptimi dhe zbatimi i drejtë i rregullave të ndihmës shtetërore, si edhe për lehtësimin e procedurave, udhëzimi paraqet në mënyrë më të plotë përcaktimin e termave apo koncepteve bazë që janë të rëndësishme për disa kategori ndihmesh horizontale, në nënndarjet respektive të tyre.

Në këtë udhëzim nuk përfshihen kategoria e ndihmave rajonale, si dhe ndihmat për shpëtimin dhe ristrukturimin e ndërmarrjeve në vështirësi. Këto kategori rregullohen me rregullore të veçanta të miratuara, përkatësisht, me vendimet nr.815 dhe nr.816 të Këshillit të Ministrave të datës 28.12.2005.

1.2 Intensiteti i ndihmës dhe kostot e pranueshme

Në mënyrë që të garantohet se ndihma është proporcionale me mangësitë që kërkon të rregullojë dhe e kufizuar vetëm në sasinë e domosdoshme, vlera e saj përcaktohet në formën e intensitetit të ndihmës që i referohet kostove të pranueshme të investimit.

Kufijtë e lejuar të intensitetit të ndihmës apo të vlerës së ndihmës përcaktohen në atë nivel që lejon vendosjen e balancës së duhur midis uljes në maksimum të efektit shtrembërues në konkurrencë për sektorin që përfiton ndihmë dhe zgjidhjes së problemeve respektive të dështimit të tregut apo të kohezionit social.

Gjithashtu, për të parë respektimin e kufijve maksimalë të intensitetit, analizohet dhe vlerësohet shuma totale e ndihmës për një veprimtari apo projekt të caktuar, pavarësisht nëse mbështetja është dhënë nga Buxheti i Shtetit, buxheti i qeverisjes vendore, apo nga donatorët.

Në llogaritjen e intensitetit të ndihmës, të gjitha të dhënat e përdorura duhet të merren përpara zbritjes së taksimit të drejtpërdrejtë. Kur ndihma nuk është dhënë në formë granti, por në ndonjë formë tjetër, atëherë vlera e ndihmës do të jetë ekuivalenti i grantit të ndihmës.

Ndihma e pagueshme në disa këste duhet të skontohej në vlerën e saj në momentin e dhënies. Norma e interesit që do të përdoret për skontimin dhe për llogaritjen e vlerës së ndihmës në formën e një kredie të zbutur do të jetë norma e referencës së përdorur në momentin e dhënies. Në rastet kur ndihma jepet në formën e përjashtimit nga taksat apo heqjen e detyrimit nga taksat në të ardhmen, skontimi i ndihmës bëhet në bazë të normës së referencës së aplikuar në momentin që ky avantazh bëhet efektiv.

Kostot e pranueshme duhet të jenë të dokumentuara qartë dhe të specifikuara, duke iu referuar llojit apo kategorisë përkatëse të ndihmës shtetërore.

1.3 Ndihma transparente

Përgjithësisht, për të siguruar transparencën, trajtimin e njëjtë, si dhe një monitorim efektiv, konsiderohen si ndihma të lejueshme ato ndihma që janë transparente.

Në vlerësimin e legjislacionit të ndihmës shtetërore, përveç granteve të drejtpërdrejta, konsiderohen ndihma transparente:

i) ndihma në formën e huave, ku llogaritja e ekuivalentit të grantit për ndihmën është bërë mbi bazën e normave të interesit që mbizotërojnë në treg në momentin e dhënies së grantit, si dhe merr parasysh ekzistencën e një siguracioni normal dhe/ose parashikimin e një risku normal lidhur me huanë;

ii) ndihma në formën e garancive, për të cilën metodologjia e llogaritjes së ekuivalentit bruto të grantit, është përcaktuar në rregulloren “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.817, datë 28.12.2005;

iii) ndihma në formën e lehtësirave të ndryshme fiskale, nëse ajo ka të përcaktuar një tavan që nuk tejkalon intensitetin maksimal të lejuar.

Sipas legjislacionit të ndihmës shtetërore, nuk konsiderohen ndihma transparente:

i) ndihma në formën e injektimit/shtimit të kapitalit;

ii) ndihma në formën e riskut të kapitalit.

Për sa i takon ndihmës në formën e parapagesës, ajo do të konsiderohet si ndihmë transparente, vetëm në rast se shuma e parapaguar nuk tejkalon intensitetin maksimal të lejuar për kategorinë përkatëse. Në rast se vlera e ndihmës është shprehur në formën e intensitetit të ndihmës, shuma totale e parapagesës, e shprehur si një përqindje e kostove të pranueshme, nuk duhet të kalojë intensitetin e ndihmës së zbatuar për kategorinë përkatëse.

1.4 Efekti nxitës i ndihmës

Për të siguruar që ndihma është absolutisht e domosdoshme dhe që ajo vepron si një nxitës për ndërmarrjet përfituese për të zhvilluar veprimtari apo për të nisur projekte të reja, ajo nuk jepet për veprimtari apo projekte, të cilat ndërmarrjet do t'i ndërmerrnin vetë, në kushte normale tregu. Prandaj, udhëzimi trajton ato kategori ndihmash, të cilat kanë një efekt nxitës.

Konsiderohet ndihmë që ka një efekt nxitës, ajo ndihmë që i mundëson përfituesit të kryejnë aktivitete ose projekte, të cilat nuk do të mund t'i vinte në zbatim në mungesë të saj.

Në rastin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, ato duhet të kenë dorëzuar një aplikim për ndihmë të dhënësi i ndihmës, përpara se të ketë filluar puna në projektin apo veprimtarinë që synohet të ndihmohet.

Ndërsa për ndërmarrjet e mëdha, dhënësi i ndihmës nuk mund të japë ndihmën individuale të parashikuar, pa verifikuar më parë që dokumentacioni i paraqitur nga përfituesi i ndihmës vërteton efektin nxitës të ndihmës, nëpërmjet plotësimit të një ose më shumë prej kritereve të mëposhtme:

i) rritjen e madhësisë së projektit/aktivitetit;

ii) shtimin e objektivave që realizohen nëpërmjet projektit/aktivitetit;

iii) rritjen e vlerës totale të shpenzuar nga përfituesi mbi projektin/aktivitetin.

Kemi parasysh që këto kërkesa nuk zbatohen për masat fiskale të përgjithshme, që përcaktohen në bazë të kriterëve objektive dhe pa lejuar ushtrimin e kompetencave diskrecionare nga dhënësi i ndihmës, gjithmonë, nëse këto masa fiskale janë vënë në zbatim përpara se të fillonte puna mbi projektet apo aktivitetet që përfitojnë ose që mund të përfitojnë prej tyre.

Në rast se nuk përmbushen kriteret e mësipërme, masa e ndihmës nuk mund të hyjë në kategorinë e ndihmave të lejueshme.

1.5 Transparenca dhe monitorimi

Dhënësit e ndihmës duhet të mbajnë të regjistruara të dhëna të hollësishme për çdo ndihmë individuale apo skemë ndihme të trajtuar nga ky udhëzim. Regjistrat e të dhënave duhet të përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm për të vendosur se janë përmbushur të gjitha kushtet për përfitimin e ndihmës, duke përfshirë informacionin mbi statusin e ndërmarrjes si SME-të, apo ndërmarrje e madhe, informacionin mbi efektin nxitës të ndihmës, si dhe informacionin që bën të mundur përcaktimin e një shume fikse të kostove të pranueshme të investimit.

Dhënësit e ndihmës duhet të mbajnë të regjistruara të dhënat për ndihmën individuale për 10 vjet nga data e dhënies së saj, ndërsa për skemat e ndihmës, për 10 vjet nga data e dhënies së ndihmës së fundit në bazë të skemës.

2. NDIHMA PËR SME-të

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme luajnë një rol vendimtar në krijimin e vendeve të punës. Më gjerësisht, ato veprojnë si një faktor nxitës i stabilitetit social dhe ekonomik. Megjithatë, zhvillimi i tyre mund të kufizohet nga defektet e tregut. Shpesh ato kanë vështirësi në sigurimin e kapitalit apo kredisë, për shkak të natyrës së veçantë të disa tregjeve financiare dhe garancive të kufizuara që ato mund të jenë në gjendje të ofrojnë. Burimet e tyre të pakta mund të kufizojnë marrjen e informacioneve, veçanërisht të atyre që kanë lidhje me teknologjinë e re dhe tregjet e mundshme.

Nuk hyjnë në kategorinë e ndihmave të lejueshme:

i) ndihma në veprimtaritë e lidhura me eksportin, të quajtura ndryshe ndihma të lidhura me sasinë e eksportuar, për ngritjen dhe zhvillimin e një rrjeti shpërndarjeje ose të shpenzimeve të tjera që lidhen me veprimtarinë e eksportit;

ii) ndihma që krijojnë përparësi për produktet e brendshme kundrejt atyre të importuara.

Ndërsa veprimtaritë e lidhura me prodhimin, përpunimin dhe marketingun e produkteve bujqësore, të listuara në protokollin II të MSA-së dhe MI-së, për periudhën transitorë nuk hyjnë në fushën e zbatimit të legjislacionit të ndihmës shtetërore. Ato trajtohen sipas rregullave të tregut të përbashkët bujqësor, të përcaktuar në marrëveshjen e OBT-së, si dhe sipas dispozitave të kapitullit II të MSA-së.

2.1 Kushtet që një ndihmë për SME-të të konsiderohet e lejueshme

Ndihma individuale jashtë skemave, do të konsiderohet e lejueshme, vetëm në rast se ajo njoftohet në Drejtorinë e Ndihmës Shtetërore, duke pasur një referencë të qartë në legjislacionin e ndihmës shtetërore dhe miratohet nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore.

Ndihmat që u jepen ndërmarrjeve në kuadër të një skeme ndihme, që përmbush të gjitha kriteret e përcaktuara, nuk do të jetë subjekt njoftimi individual në Drejtorinë e Ndihmës Shtetërore, vetëm në rastet kur skema ka marrë paraprakisht miratimin e Komisionit të Ndihmës Shtetërore dhe çdo ndihmë që mund të jepet sipas kësaj skeme, ka përmbushur të gjitha kriteret e përcaktuara në vendimin përkatës të KNSH-së.

Pavarësisht se ndihma mund të hyjë në kategorinë e ndihmave që lejohen, në asnjë rast ajo nuk vihet në zbatim përpara se Komisioni të marrë një vendim për lejimin e saj, me ose pa kushte.

2.2 Përkufizime

Për shpjegim më të mirë të kësaj nënndarje, termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

a) “investim fillestar” është investimi në kapital të patundshëm për ngritjen e një ndërmarrjeje të re; për zgjerimin e një ndërmarrjeje ekzistuese; për rritjen e llojshmërisë së produkteve, nëpërmjet prodhimit të produkteve të reja tregtare, për ndryshime thelbësore të produkteve ose të proceseve të prodhimit; si dhe për blerjen e një ndërmarrjeje, një linje prodhimi apo dege të saj, që është mbyllur ose që do të mbyllet, nëse nuk do të blihej;

b) “numri i punonjësve” është numri i njësive vjetore të punës, që do të thotë numri i personave të punësuar me kohë të plotë gjatë një viti. Personat e punësuar me kohë të pjesshme dhe ata sezonalë do të llogariten si fraksione të numrit të njësive vjetore të punës;

c) “punonjës në vështirësi” është çdo person që i përket një kategorie shoqërore, e cila pa pasur një përkrahje e ka të vështirë të hyjë në tregun e punës, kryesisht një person që përmbush të paktën një nga kushtet e mëposhtme:

i) çdo person nën moshën 25 vjeç ose që ka dy vjet që ka mbaruar arsimin pa shkëputje nga puna

dhe që nuk ka pasur një punë të parë të rregullt dhe të paguar;

ii) çdo person që është një anëtar i një minoriteti etnik brenda vendit dhe që kërkon zhvillimin e aftësive të tij/saj ligjore, trajnim profesional ose përvojë pune për të përmirësuar shpresat e tij për të filluar një punë të qëndrueshme;

iii) çdo person që dëshiron të hyjë ose të rihyjë në punë, që ka qenë pa punë dhe që nuk ka qenë duke u arsimuar për dy vitet e fundit, veçanërisht çdo person, që lë punën për shkak të vështirësive për të përballuar edhe punën edhe familjen;

iv) çdo person që jeton si beqar i rritur dhe që ka në ngarkim një ose më shumë fëmijë;

v) çdo person që nuk ka kryer arsimin e mesëm ose ekuivalentin e tij, që nuk ka një punë ose që ka humbur punën e tij/saj;

vi) çdo person më i madh se 50 vjeç, që nuk është në punë ose që ka humbur punën e tij/saj;

vii) çdo person që ka një periudhë të gjatë pa punë, p.sh. çdo person që ka qenë pa punë për 12 nga 16 muajt e fundit, ose, për personat nën 25 vjeç, gjashtë nga tetë muajt e fundit;

viii) çdo person që nuk ka filluar punën e tij të parë të rregullt dhe të paguar që nga fillimi i periudhës së burgosjes ose masave të tjera penale;

d) “punonjës me aftësi të kufizuar” është çdo person i cili njihet si i tillë në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi ose ka një dëmtim fizik, mendor dhe psikologjik serioz dhe të njohur, pra nuk është i aftë të zërë një vend pune në tregun e hapur të punës;

e) “punësimi i shtresave që merren nën mbrojtje” do të thotë punësimi në një ndërmarrje ku të paktën 50% e të punësuarve janë punonjës me aftësi të kufizuar.

2.3 Kushtet e dhënies së ndihmës për investim për SME-të

Ndihma për SME-të për investim në asete të prekshme dhe të paprekshme do të konsiderohet ndihmë e lejueshme nëse përmbush të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 13 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”.

Megjithatë, për ndihmën për investim fillestar për SME-të mund të zbatohen edhe kufijtë e intensitetit të përcaktuar në nenet 4 dhe 5 të rregullores “Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.815.

Nëse ndihma për SME-të jepet në kuadër të ndihmës rajonale për investim, mund të zbatohet kufiri maksimal i intensitetit, vetëm nëse ndihma është dhënë me kushtin që investimi të ruhet për të paktën pesë vjet, në rajonin përkatës dhe që kontributi i përfituesit të jetë të paktën 25%.

Kufijtë e përcaktuar duhet të zbatohen për intensitetin e ndihmës së llogaritur si përqindje e kostove të pranueshme të investimeve ose si përqindje e kostove të pagave për vendet e punës të krijuara nga kryerja e një investimi (ndihma për krijimin e vendeve të reja të punës), ose si një kombinim i tyre që parashikon se, me çfarëdo llogaritje, ndihma nuk kalon kufirin maksimal të lejuar.

Në rastet kur ndihma llogaritet në bazë të kostove të investimit, kostot e pranueshme të investimeve të prekshme duhet të jenë kostot që lidhen me investimet për tokën, ndërtesat, makineritë dhe pajisjet.

Ndërsa kostot e pranueshme të investimeve të paprekshme janë kostot që lidhen me transferimin e teknologjisë, nëpërmjet zotërimit të patentave, licencave operacionale dhe licencave të njohurive, të mbrojtura dhe të pambrojtura, me kusht që ato:

i) të përdoren vetëm në ndërmarrjen, linjën apo degën e saj, për të cilën merret ndihma rajonale;

ii) të konsiderohen si aktive të amortizueshme;

iii) të blihen nga palët e treta me kushtet e tregut;

iv) të përfshihen në aktivet e ndërmarrjes, linjës apo degës së saj, që merr ndihmë rajonale dhe të qëndrojnë në të për një periudhë jo më pak se pesë vjet.

Në sektorin e transportit, me përjashtim të inventarit hekurudhor, mjetet dhe pajisjet e transportit nuk duhet të përfshihen në kostot e pranueshme. Kostot e pranueshme për investimet e paprekshme, në këtë sektor, duhet të jenë kostot e përvetësimit të teknologjisë.

2.4 Kushtet e dhënies së ndihmës për punësim për SME-të, në kuadër të ndihmës rajonale

Në rastet kur ndihma llogaritet në bazë të krijimit të vendeve të reja të punës, masa e ndihmës duhet të shprehet në përqindjen e kostove të pagave për një periudhë dyvjeçare, duke u lidhur me krijimin e vendeve të punës sipas kushteve të mëposhtme:

i) krijimi i vendeve të reja të punës është i lidhur me zbatimin e një projekti investimi në asete të prekshme dhe të paprekshme. Vendet e punës duhet të krijohen brenda tri viteve nga përfundimi i investimit;

ii) projekti i investimit ndiqet nga një rritje e numrit të punonjësve në ndërmarrjet përkatëse, duke u krahasuar me mesataren e dymbëdhjetë muajve të mëparshëm; dhe

iii) vendet e reja të punës duhet të mbahen për një periudhë minimale prej pesë vjetësh.

2.4.1 Punësimi i punonjësve në vështirësi dhe i punonjësve me aftësi të kufizuara në formën e subvencioneve të pagës

Intensiteti i ndihmës në rastin e skemave të ndihmës për punësimin e punonjësve në vështirësi nuk duhet të kalojë 50% të kostove të pranueshme, ndërsa në rastin e skemave për punësimin e punonjësve me aftësi të kufizuara, intensiteti i ndihmës nuk duhet të kalojë 60% të kostove të pranueshme, duke zbatuar kushtet në vazhdim:

i) kur punësimi nuk përfaqëson një rritje neto të numrit të punonjësve në ndërmarrjen në fjalë, vendi ose vendet e punës duhet të jenë lënë vakant nga një largim vullnetar, dalje në pension, ulje vullnetare e orëve të punës ose largim i ligjshëm nga puna për sjellje të keqe dhe jo si rezultat i ristrukturimit për shkak të numrit të tepërt të punonjësve; dhe

ii) përveç rasteve të pushimit të ligjshëm nga puna për sjellje të keqe, punëtori ose punëtorët duhet të mbahen në punë pa shkëputje për të paktën 12 muaj.

Kostot e pranueshme duhet të jenë kostot e pagës, të llogaritura mbi një periudhë maksimale prej 12 muajsh.

2.4.2 Kostot shtesë për punësimin e punonjësve me aftësi të kufizuara

Që të konsiderohen të lejueshme, skemat e ndihmës për punësimin e punonjësve me aftësi të kufizuara dhe çdo ndihmë që mund të jepet sipas këtyre skemave, duhet të përmbushë edhe disa kushte të tjera.

Ndihma për punësim, së bashku me çdo ndihmë të dhënë, nuk duhet të kalojë nivelin e dëshiruar për kompensimin e:

- produktivitetit të ulur për shkak të paaftësisë të punëtorit ose punëtorëve,
- kostove për përshtatjen e godinave,
- kostot e stafit të punësuar vetëm për kohën që harxhohet për asistencën e punëtorit ose punëtorëve me aftësi të kufizuara, dhe
- kostot e përshtatjes ose blerjes së pajisjeve për përdorimin e tyre,

të cilat janë shtesë e atyre kostove që përfituesi do të përballonte nëse do të punësonte punonjës të tjerë, gjatë një periudhe për të cilën janë të punësuar punonjësit me aftësi të kufizuara.

Kur përfituesi ofron punësim duke garantuar mbrojtjen e kategorive të caktuara të punonjësve, ndihma mund të konsiderohet e lejueshme, por me kusht që të mos kalojë kostot e ndërtimit, instalimit ose zgjerimit të ndërmarrjes në fjalë, si edhe çdo kosto administrimi dhe transporti, të cilat rezultojnë nga punësimi i këtyre kategorive.

2.4.3 Masa që nuk konsiderohen ndihma të lejueshme për punësim

Skemat e ndihmës për punësim, që jepen vetëm për sektorë të veçantë, në parim nuk hyjnë në kategorinë e ndihmave të lejueshme.

Vëmendja e Komisionit të Ndhmës Shtetërore do të përqendrohet në ndihmat individuale, pra që jepen për një ndërmarrje të vetme, si dhe për ato skema ndihme për nxitjen e marrjes në punë të kategorive të punonjësve, që nuk konsiderohen në vështirësi apo nuk janë me aftësi të kufizuara. Në njoftim, dhënësit e ndihmës do të paraqesin për vlerësim argumentet dhe të gjithë indikatorët ekonomikë që tregojnë se punonjësit apo ndërmarrjet në fjalë kanë realisht nevojë për një mbështetje të tillë.

Gjithashtu, me shumë vëmendje do të shqyrtohet ndihma për të mbajtur vendet e punës, kryesisht mbështetja financiare e dhënë për një ndërmarrje për të mbajtur ende në punë punonjësit të cilët, në të kundërt do të pushoheshin. Për çdo rast të tillë, plani për dhënien e ndihmës do të njoftohet pranë Drejtorisë së Ndhmës Shtetërore. Në varësi të ndonjë rregulli të veçantë sektorial, një ndihmë e tillë mund të miratohet nga Komisioni, vetëm nëse ajo synon të rregullojë dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose rrethana të jashtëzakonshme, ose sipas kushteve të zbatuara për ndihmën rajonale, pra që të jetë e lidhur me zhvillimin ekonomik të zonave ku standardi i jetesës është jashtëzakonisht i ulët ose kur ekziston një papunësi e lartë.

Po në këtë kontekst do të shqyrtohet ndihma për shndërrimin e kontratave të përkohshme ose të pandryshuara të punësimit në kontrata me kohëzgjatje të pacaktuar, si dhe skemat e ndihmës për ndarjen e punës, për ofrimin e mbështetjes për patentat e punës dhe masa të ngjashme punësimi, të cilat nxisin punësimin, por që nuk çojnë në një rritje neto të punësimit, në marrjen në punë të punonjësve në vështirësi ose të punonjësve me aftësi të kufizuara.

Gjithashtu, masa të tjera ndihme që lidhen me punësimin dhe tregjet e punës, të tilla si: masat për të nxitur daljen para kohe në pension, si dhe rastet individuale të ndihmës për punësim, të dhëna jashtë

ndonjë skeme, do të kërkojnë njoftime të veçanta pranë DNSH. Kategori të tilla do të vlerësohen në bazë të legjislacionit dhe mund të miratohen nga Komisioni i Ndhmës Shtetërore, vetëm nëse janë në përputhje me ndonjë rregull të veçantë, i cili mund të jetë miratuar për sektorin në të cilin vepron përfituesi dhe, vetëm nëse mund të tregohet që efektet e ndihmës në punësim janë më të mëdha se ndikimi në konkurrencë në tregun përkatës.

2.5 Ndhma për SME-të në formën e shërbimeve këshillimore

Që ndihma për shërbime këshillimore për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të konsiderohet e lejueshme, duhet që intensiteti i saj të mos kalojë 50% të kostove të pranueshme. Kostot e pranueshme duhet të jenë kostot e këshillimit për shërbimet e ofruara nga konsulentë të jashtëm.

Shërbimet e lartpërmendura nuk duhet të jenë aktivitete në vazhdimësi apo periodike dhe që lidhen me kostot operationale të zakonshme të ndërmarrjes ose shpenzimet korrente, siç mund të jenë shërbimet këshillimore për taksat, shërbimet ligjore apo reklamata.

2.6 Ndhma për pjesëmarrjen e SME-ve në panaire

Ndhma për pjesëmarrjen në panaire të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme do të quhet e lejueshme nëse intensiteti i ndihmës nuk kalon 50% të kostove të pranueshme. Kostot e pranueshme duhet të jenë kostot që shërbejnë për dhënien më qira, ngritjen dhe funksionimin e standave apo të vendqëndrimit për pjesëmarrjen e parë të një ndërmarrjeje në një panair apo ekspozitë të veçantë.

3. NDIHMA PËR KËRKIM DHE ZHVILLIM

Ndhma për kërkim dhe zhvillim kontribuon në rritjen e ekonomisë, forcimin e konkurrencës dhe rritjen e nivelit të punësimit. Duke pasur parasysh mundësitë e kufizuara që kanë jo vetëm SME-të, por dhe ndërmarrjet e mëdha për të kryer kërkim dhe zhvillim, defektet e tregut mund t'i pengojnë ato në arritjen e një prodhimi optimal. Kjo do të sjellë rezultate të dobëta, të cilat lidhen kryesisht me eksternalitetet pozitive¹, mallrat publikë, informacionin asimetrik, rrjetin dhe koordinimin e defekteve.

Ndhma për kërkim dhe zhvillim është, veçanërisht e rëndësishme për SME-të, sepse një nga mangësitë e tyre strukturore, ka të bëjë pikërisht me vështirësinë për të pasur akses në zhvillimet e reja të teknologjisë, transferimin e teknologjisë ose të burimeve njerëzore shumë të kualifikuara. Ndaj ndihma për projektet për kërkim dhe zhvillim për SME-të, ndihma për kryerjen e studimeve teknike dhe ndihma për mbulimin e kostove mbi të drejtat e pronësisë industriale, përgjithësisht, konsiderohen ndihma që mund të lejohen.

3.1 Përkufizime

Për shpjegim më të mirë të kësaj nënndarje, termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

a) “organizatë kërkimore” do të thotë një entitet, siç mund të jetë një universitet apo institut kërkimi, i pavarur nga statusi i tij ligjor (person juridik, privat apo publik) ose nga mjetet e tij të financimit, tek i cili qëllimi kryesor është të drejtojë kërkime bazë, kërkime industriale apo zhvillime eksperimentale dhe të përhapë rezultatet e tyre me anë të mësim, publikimit apo teknologjisë. Të gjitha përfitimet duhet të riinvestohen në këto veprimtari, me anë të përhapjes së rezultateve të tyre apo mësim;

b) “kërkim bazë” do të thotë punë eksperimentale apo teorike, e ndërmarrë fillimisht për të siguruar njohuri të reja, mbi bazën e fenomeneve dhe fakteve të dukshme dhe pa pasur një zbatim të drejtpërdrejtë praktik ose përdorim të tyre;

c) “kërkim industrial” do të thotë kërkim i planifikuar apo hetim vendimtar që ka si qëllim sigurimin e njohurive të reja dhe aftësive për të krijuar produkte të reja, procese apo shërbime, ose për të sjellë një përmirësim të dukshëm në produktet, proceset apo shërbimet ekzistuese. Kërkimi industrial përfshin edhe krijimin e pjesëve përbërëse të sistemit, të nevojshme për realizimin e kërkimit industrial, veçanërisht për miratimin e teknologjisë së përgjithshme;

d) “kërkim parakonkurrues” do të thotë sigurimi, kombinimi, formimi dhe përdorimi i bizneseve ekzistuese specifike dhe teknologjike, si dhe i njohurive dhe aftësive të tjera të nevojshme, me qëllim përgatitjen e planeve dhe marrjen e masave për produktet e reja, për proceset ose shërbimet që ndryshohen apo përmirësohen. Këtu mund të përfshihen edhe aktivitete të tjera që kanë si qëllim saktësimin konceptual, planifikimin dhe dokumentimin e produkteve të reja, proceseve apo shërbimeve. Aktivitetet mund të përfshijnë planprodhimin, planet studimore dhe dokumente të tjera, por që nuk përdoren për qëllime tregtare. Zhvillimi eksperimental nuk përfshin ndryshimet rutinë apo periodike të produkteve, të linjave të prodhimit, të industrisë përpunuese, të shërbimeve ekzistuese dhe veprimtarive të tjera në proces, edhe kur këto ndryshime paraqesin përmirësim;

e) “prototip” është produkti final tregtar dhe, kur është tejet i shtrenjtë, prodhimi i tij vetëm për t'u

¹ Eksternalitete positive ekzistojnë kur përfitimi shtesë i shoqërisë nga prodhimi ose konsumi e tejkalon përfitimin marxhinal të ndërmarrjes.

përdorur për qëllime demonstrimi dhe miratimi. Në rast përdorimi të tillë, të ardhurat që sigurohen nga ky përdorim duhet të zbriten nga kostot e pranueshme. Konsiderohen si kosto të pranueshme për prototipet, kostot e prodhimit dhe testimi eksperimental të produkteve, të proceseve dhe të shërbimeve, me kushtin që këto të përdoren apo transformohen në fushën industriale apo tregtare.

3.2 Ndhimja për projektet për kërkim dhe zhvillim

Ndhimja për projektet për kërkim dhe zhvillim vlerësohet në bazë të shkallës së saj të përputhshmërisë dhe plotësisë të kushteve të përcaktuara.

Në rastin e dhënies së ndihmës, pjesët e asistuar të projektit, duhet të përfshijnë kategoritë e kërkimit bazë, kërkimit industrial dhe zhvillimit eksperimental.

Kur një projekt përfshin detyra të ndryshme, çdo detyrë duhet të cilësohet nën një nga kategoritë e mësipërme, ose mund të mos cilësohet në asnjërën prej këtyre kategorive.

Ndonëse intensiteti maksimal i ndihmës nuk duhet të kalojë:

- i) 100% për kërkimin bazë,
- ii) 60% për kërkimin industrial, dhe
- iii) 35% për kërkimin parakonkurrues,

intensiteti i ndihmës për kërkimin industrial dhe atë parakonkurrues mund të shkojë deri në kufijtë maksimalë të lejuar me rregulloren “Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale”.

Në rastin e ndihmës shtetërore për projektet për kërkim dhe zhvillim, të zbatuara në bashkëpunim me organizata dhe ndërmarrje ndërkombëtare, intensiteti i ndihmës llogaritet duke akumuluar ndihmën e marrë nga Buxheti i Shtetit me kontributin e dhënë për atë projekt prej organizatave ndërkombëtare dhe/apo kërkimore.

Kostot e pranueshme, në këtë rast, janë:

i) kostot e personelit (punonjësit kërkimorë-shkencorë, teknikët dhe pjesa tjetër e stafit mbështetës të punësuar mbi këtë projekt);

ii) kostot për mjetet dhe pajisjet për periudhën e përdorur për projektin kërkimor;

iii) kostot për ndërtesat dhe tokën, për kohëzgjatjen e projektit kërkimor. Për sa i përket ndërtesave, quhen kosto të pranueshme vetëm ato të amortizimit që lidhet me jetëgjatësinë e projektit, i llogaritur mbi bazën normave përkatëse të amortizimit, të përcaktuara në kontabilitet;

iv) kostot për shërbimet e këshillimit, njohuri teknike dhe blerjen e patentave apo licencave nga burime jashtë projektit me kosto të tregut, ku transaksioni është zbatuar dhe nuk ka pasur asnjë marrëveshje të fshehtë, si dhe kostot për këshillim dhe shërbimet ekuivalente të përdorura ekskluzivisht për aktivitetin kërkimor;

v) shpenzime shtesë, si pasojë e projektit kërkimor;

vi) shpenzime të tjera operative, që përfshijë kostot për materiale, për furnizim apo produkte të barasvlershme, si rrjedhim i drejtpërdrejtë i aktivitetit kërkimor.

3.3 Ndhimja për kryerjen e studimeve teknike

Në ndihmën për kërkim dhe zhvillim hyn edhe ndihma për kryerjen e studimeve teknike paraprake të kërkimeve industriale apo kërkimit parakonkurrues. Kostot e pranueshme, në këtë rast, janë kostot e studimit.

3.4 Ndhimja për mbulimin e kostove të të drejtave të pronësisë industriale për SME-të

Edhe ndihma për përballimin e kostove që lidhen me marrjen dhe vërtetimin e patentave dhe të drejtave të tjera të pronësisë industriale mund të lejohet, nëse intensiteti i ndihmës nuk tejkalon kufijtë maksimalë të intensitetit, sipas kategorive përkatëse të kërkimit, të përcaktuara në pikën 3.1.

Kostot e pranueshme, në këtë rast, do të konsiderohen:

i) të gjitha kostot që paraprijnë grantin për të drejtën në shkallën e parë, duke përfshirë këtu edhe kostot që lidhen me përgatitjen, plotësimin dhe ndjekjen e aplikimit, si dhe kostot që rrjedhin nga përsëritja e aplikimit përpara se të jepet e drejta;

ii) përkthimi dhe kosto të tjera, si pasojë e dhënies apo vërtetimit të së drejtës në instanca të tjera gjyqësore;

iii) kosto që vijnë nga vërtetimi i së drejtës gjatë një akuze zyrtare të zbatimit dhe kundërshtimin e mundshëm të një akti, edhe në rast se këto kosto vijnë pas dhënies së të drejtës.

4. NDIHMA PËR TRAJNIM

Trajnimi sjell efekt pozitiv për shoqërinë, sepse ai rrit numrin e punonjësve të trajnuar duke përmirësuar konkurrencën në industrinë vendase dhe duke luajtur një rol të rëndësishëm në strategjinë e punësimit në vend. Trajnimi, përfshirë këtu edhe njohurinë mbi elektronikën, është i rëndësishëm për krijimin, përvetësimin dhe përhapjen e njohurive, pra konsiderohet me rëndësi të madhe publike. Ndaj ndihma për trajnim hyn në kategorinë e ndihmave që mund të lejohen.

Ndihma për trajnimin e përgjithshëm ka efekt më të vogël në shtrembërimin e konkurrencës, që do të thotë se për të mund të lejohen kufij më të lartë të intensitetit. Trajnimi i veçantë, në të cilën përfituesi kryesor është ndërmarrja, sjell një rrezik më të lartë për dëmtimin e konkurrencës, prandaj, kufiri i lejuar i intensitetit të ndihmës duhet të jetë më i vogël.

4.1 Përkufizime

Për shpjegim më të mirë të kësaj nënndarje, termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

a) “trajnimi specifik” është trajnimi që përfshin shkollimin e drejtpërdrejtë dhe në parim të zbatueshëm për punonjësit ekzistues ose vendet e ardhshme të punës në ndërmarrjet e ndihmuara dhe që siguron kualifikime, të cilat nuk janë të transferueshme ose janë shumë pak të transferueshme te ndërmarrjet ose sektorët e tjerë;

b) “trajnim i përgjithshëm” është trajnimi që përfshin shkollimin që nuk është i zbatueshëm vetëm ose kryesisht për punonjësit ekzistues dhe për vendet e ardhshme të punës në ndërmarrjet e ndihmuara, por që siguron kualifikime që janë shumë të transferueshme te ndërmarrjet ose sektorët e tjerë dhe, në këtë mënyrë, përmirëson dukshëm mundësinë e punonjësve për të gjetur punë.

Trajnimi do të konsiderohet “i përgjithshëm” nëse, për shembull:

- ai është i organizuar së bashku nga disa ndërmarrje të pavarura ose, nëse punonjësit në ndërmarrje të ndryshme mund të vetë trajnohen;

- ai njihet, certifikohet ose vërtetohet nga autoritetet ose organet publike ose nga organe apo institucione të tjera, të cilit i është dhënë autoriteti i nevojshëm për këtë.

4.2 Kushtet e dhënies së ndihmës për trajnim

Në rastet kur projekti i ndihmës përfshin elemente si të trajnimit specifik, ashtu edhe trajnimit të përgjithshëm, të cilët nuk mund të ndahen për llogaritjen e intensitetit të ndihmës, si dhe në rastet kur nuk mund të përcaktohet karakteri specifik ose i përgjithshëm i ndihmës për trajnim, intensitetet e zbatueshme do të jenë ato të trajnimit specifik.

Kostot e pranueshme në ndihmën për trajnim konsiderohen:

- i) kostot personale të trajnuesve;
- ii) shpenzimet e udhëtimit të trajnuesve dhe të të trajnuarve;
- iii) shpenzime të tjera qarkulluese, të tilla si: materialet dhe furnizimet;
- iv) amortizimi i mjeteve dhe pajisjeve në masën që ato përdoren vetëm për projektin e trajnimit;
- v) kostoja e udhëzimit dhe shërbimeve këshillimore që lidhen me projektin e trajnimit;
- vi) kostot personale të të trajnuarve deri në vlerën e totalit të kostove të tjera të pranueshme të referuara në “a” deri “e”. Mund të llogariten vetëm orët gjatë të cilave të trajnuarit marrin pjesë në trajnim, pas zbritjes së ndonjë ore prodhuese ose ekuivalentit të tyre.

Kostot e pranueshme duhet të shoqërohen me të dhëna të dokumentuara, të cilat duhet të jenë transparente.

5. NDIHMA PËR RISKUN E KAPITALIT

Një nga arsytet e defekteve në treg është ekzistenca e riskut të kapitalit. Shpesh, ndërmarrjet nuk kanë mundësi të sigurojnë burime financiare, megjithëse zotërojnë një plan biznesi të mirë, që premton për shëndoshjen financiare të tyre. Shkaku kryesor i defekteve në treg, që ndikon në mundësinë për sigurimin e kapitalit, veçanërisht nga vetë SME-të, është informacioni asimetrik. Skemat e riskut të kapitalit për SME-të, që marrin formën e burimeve të investimit, në të cilën një pjesë e konsiderueshme e burimeve vijnë si kapital privat, mund të konsiderohen ndihma të lejueshme.

5.1 Përkufizime

Për shpjegim më të mirë të kësaj nënndarje, termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

a) “kapital i vet” kupton pretendimin e pronarëve të ndërmarrjes, që përfaqësohen nga aksionet që janë emetuar për themeluesit e saj;

b) “kapital potencial” kupton instrumentet financiare, kthimi i të cilave për mbajtësin e saj bazohet në fitimin ose humbjet që parashikon ndërmarrja dhe nuk janë të sigurta në rast mospagimi;

c) “kapital privat” kupton kapitalin ose investimin në kapital potencial në ndërmarrjet që nuk janë të listuara në bursë, përfshirë edhe kapitalin që sigurohet nga investitorë të jashtëm të specializuar;

d) “kapital fillestar” kupton burimin e financimit që nevojitet për studimin, vlerësimin dhe zhvillimin e një koncepti fillestar, duke i paraprirë fazës së themelimit;

e) “kapital i themelimit” kupton burimin e financimit që sigurohet nga ndërmarrjet, të cilat nuk kanë shitur produktet ose shërbimet e tyre në treg dhe ende nuk kanë krijuar një fitim nga zhvillimi dhe marketingu i produktit;

f) “kapital i zgjerimit” kupton burimin e financimit që nevojitet për rritjen dhe zgjerimin e një ndërmarrjeje, e cila mund ose nuk mund të ushtrojë veprimtarinë e saj fitimprurëse, me qëllim rritjen e

kapaciteteve të prodhimit, zhvillimit të tregut/të produkteve ose krijimin e një kapitali qarkullues shtesë;

g) “strategji e daljes” kupton një strategji për likuidimin e aksioneve që zotërohen nga investitorët e jashtëm të specializuar ose nga fondet e kapitalit privat, në përputhje me një plan, i cili synon normën maksimale të kthimit të investimit, duke përfshirë:

- shitjen në treg të aksioneve;
- heqjen nga pasqyra e bilancit të inventarit të dëmtuar;
- ripagesën e aksioneve të preferuara/borxheve;
- shitjen të një investitor tjetër i jashtëm;
- shitjen të një institucion financiar; dhe
- shitjen nëpërmjet një oferte publike (përfshirë oferta publike primare);

h) “ndërmarrja e synuar” kupton një ndërmarrje tek e cila synon të investojë një investitor ose një fond investimi.

5.2 Kushtet për dhënien e ndihmës në formën e riskut të kapitalit

Ndihma duhet të ketë formën e pjesëmarrjes në një fond investimi fitimprurës, i cili menaxhohet, duke u mbështetur në mekanizmat e funksionimit të tregut.

Për SME-të që ndodhen në zonat e thella, sikurse edhe për ndërmarrjet e vogla që ndodhen në zonat e tjera, ndihma nëpërmjet riskut të kapitalit duhet të jetë e kufizuar vetëm në vlerën e nevojshme për sigurimin e burimit të financimit të kapitalit fillestar, kapitalit të themelimit dhe/ose kapitalit të zgjerimit. Për ndërmarrjet e mesme që nuk ndodhen në zonat e thella, ndihma nëpërmjet riskut të kapitalit do të jetë e kufizuar vetëm në vlerën e nevojshme për sigurimin e burimit të financimit të kapitalit fillestar dhe/ose kapitalit të themelimit, duke përjashtuar kapitalin e zgjerimit.

Në mënyrë që të sigurohet se ndihma nëpërmjet riskut të kapitalit është dobiprurëse kërkohet që:

- i) të ekzistojë një plan biznesi për çdo investim, i cili duhet të përmbajë të dhëna të hollësishme për produktet, shitjet dhe rentabilitetin, si dhe të paraqitet vizioni që do ketë projekti; dhe
- ii) të ekzistojë një strategji e qartë dhe realiste për çdo investim.

Nga ana tjetër, për t’u siguruar se menaxhimi i fondeve të investimit kryhet mbështetur në mekanizmat e tregut, duhet që:

i) të ekzistojë një marrëveshje mes një menaxheri fondi/një kompanie menaxhimi dhe pjesëmarrësve në fond, duke mundësuar varësinë e shpërblimit të menaxherit nga performanca dhe objektivat e vëna nga fondi. Marrëveshja duhet të parashikojë kohëzgjatjen e investimit; dhe

ii) investitorët në kapitalin privat duhet të përfaqësohen në strukturën e fondit të investimit, si për shembull nga një komitet investitorësh ose këshilltarësh; dhe

iii) në menaxhimin e fondit duhet të aplikohen praktikat më të mira dhe mbikëqyrja.